



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija za Privatizaciju**

239

RAPORTI VJETOR FINANCIAR

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

Neni 13: PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE	4
Neni 14: RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	5
1.1. POLITIKAT KONTABËL.....	6
1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE.....	6
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA	7
1.4. SHUMAT RAPORTUESE.....	7
1.5. VALUTA RAPORTUESE	7
1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	8
Neni 14.6: SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT.....	8
SHËNIMI 2 PAGA DHE SHITESAT	14
2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË dhe Buxheti shtesë në kategorinë e pagave për vitin fiskal 2025	15
2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË Kodi: “Funksionarët me kohë të pjesshme” (11441).....	18
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME	19
3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME	21
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE	22
SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	23
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE	24
SHËNIMI 7 TJERA.....	25
SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE	26
SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE.....	26
SHËNIMI 10 TË ARDHURAT E DEDIKUARA	27
10.1. TË ARDHURAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË	27
SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE.....	28
SHËNIME TJERA 12	29
SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA	29
Neni 16 TË ARKËTUESHMET	29
Neni 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA	30
Neni 18 DETYRIMET KONTINGJENTE	31
Neni 19 RAPORT PËR PASURINË JO FINANCIARE.....	34
19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)	34

19.3.2 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO).....	35
19.3.3 STOQET.....	36
Neni 20 RAPORT PËR AVANCE E PAARSYETUARA.....	37
Neni 21 RAPORT PËR TË HYRAT VETANAKE TË PASHPENZUARA.....	37
Neni 22 RAPORT PËR BILANCET E PASHPENZUARA TË FONDIT ZHVILLIMOR NË MIRËBESIM	38
Neni 23 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA	38
Neni 24 RAPORT PËR FONDET E DONATORËVE TË PASHPENZUARA	39
Neni 25 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE	39
Neni 26 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE JASHTË LISTËS SË PAGAVE	41
Neni 27 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE ME KONTRATE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA.....	42
Neni 28 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	42

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 13: PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE**Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

		2025	2024	2023
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
	Shënime	BKK '000	BKK '000	BKK '000
BURIMET E FONDEVE - Pranimet				
Granti Qeveritar		4,312	4,553	4,594
Të hyrat vetanake		-	-	-
Të hyrat e dedikuara		-	-	-
Të hyrat nga AKP		-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve		-	-	-
Klauzola e investimeve		-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim		-	-	-
	GJITHSEJ	4,312	4,553	4,594
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - Pagesat				
Operacionet				
Paga dhe Shtesa	2	3,307	3,467	3,620
Mallra dhe Shërbime	3	841	924	879
Shpenzime Komunale	4	110	106	82
	GJITHSEJ	4,258	4,497	4,581
Transferet				
Transfere dhe Subvencione	5	-	-	-
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	54	56	13
Pagesa tjera				
	7	-	-	-
	GJITHSEJ	4,312	4,553	4,594

Neni 14: RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT**Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

		Janar – Dhjetor 2025				2024	2023
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
Shënime		A '000	B '000	C '000	D=B-A '000	E '000	F '000
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	8	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	9	-	-	-	-	-	-
*Të hyrat e dedikuara	10	-	-	-	-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	-	-	-	-	-	-
Tjera	12	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		-	-	-	-	-	-
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Paga dhe shtesa	2	3,307	3,308	3,662	1	3,467	3,620
Mallra dhe shërbime	3	841	895	1,105	54	924	879
Shpenzime komunale	4	110	110	110	-	106	82
Transfere dhe subvencione	5	-	-	5	-	-	-
Shpenzime kapitale	6	54	230	230	176	56	13
Tjerrat	7	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		4,312	4,543	5,112	231	4,553	4,594

*AKP nuk planifikon të hyra. AKP vetëm depoziton mjetet (Të Hyrat e Dedikuara) në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës për të mbuluar buxhetin e aprovuar me Ligjin e Buxhetit. AKP, nuk planifikon të hyrat si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është kërkuar që të raportohet në këtë mënyrë. Detajet janë të shpalosura në shënimin nr. 10 dhe nr. 23.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1.1. POLITIKAT KONTABËL

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik si dhe rregullores të Ministrisë së Financave Nr. 01/2017 “ Për Raportim Financiar për Organizatat Buxhetore”. Rregullorja i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007 dhe Ligjin 08/L-183 për mbështetjen e punëve publike.

1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës bëhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit, MFPT.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është një organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit Nr. 04/L-034, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/-L-080, ligjin Nr. 04/L-115 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës si dhe ndryshim plotësimin me ligjin Nr. 06/L-023.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të ligjit nr. 06/L -023.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktiviteteve dhe informatave financiare dhe jo financiare për vitin fiskal 2025.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve). Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja deri në përmbylljen e procesit të likuidimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës të NSh-ve.

Në përputhje me nenin 16 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë, Menaxhmenti i AKP-së përbëhet nga:

- Drejtori Ekzekutiv, i emëruar z. Burim Leci, në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës (U.D.);
- Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Operativë, i emëruar z. Petrit Ibraj, në cilësinë e U.D., meqenëse z. Burim Leci është emëruar U.D. në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv; dhe
- Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Funksione të Përgjithshme, i emëruar z. Ibrahim Gjyliden.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Më 30 shtator 2024, Bordi i Drejtorëve të AKP-së pranoi dorëheqjen e z. Arben Limani, Drejtor Ekzekutiv, me efekt nga data 21 nëntor 2024. Nga data 22 nëntor 2024 deri më 6 korrik 2025, në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv ishte emëruar z. Ibrahim Gjylderan, në cilësinë e U.D.

Nga data 7 korrik 2025, me vendim të Bordit të Drejtorëve, është emëruar z. Burim Leci në cilësinë e U.D. Drejtor Ekzekutiv.

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej **1 janar deri më 31 dhjetor 2025**. Buxheti i AKP-së gjatë periudhës raportuese është financuar nga **Granti Qeveritar (GQ)**.

Të hyrat e Dedikuara (THD) - Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, **janë**: *Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë.*

Granti Qeveritar (GQ) është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, nga Granti Qeveritar janë financuar të gjitha aktivitetet administrative dhe operative për vitin fiskal 2025.

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA

Në zbatim të SNKSP pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.4. SHUMAT RAPORTUESE

Shumat raportuese nga formati i pasqyrave financiare nga neni 13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€) dhe nga neni 16 deri te neni 24 shumat janë të plota Euro (€).

1.5. VALUTA RAPORTUESE

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€).

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare autorizohen në datën e nënshkrimit të deklaratës së Pasqyrave Financiare nga Z. Burim Leci, U.D. Drejtor Ekzekutiv (Zyrtar Kryesorë Administrativ) dhe Z. Adem Selishta - Drejtor i Financave dhe Buxhetit (Zyrtar Kryesorë Financiar).

Neni 14.6: SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuara nga LMFPP					Të hyrat vetanake	Burime tjera të financimit	Buxheti përfundimtar SIMFK
	Buxheti Fillestar (Ligji Nr. 08/L-332)	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 03/261	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 01/276	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 01/281	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 04/282			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrjet								
Të hyrat tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-	-	-	-
Grandet e përcaktuara të donatorëve	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-	-	-	-
Daljet								
Paga dhe shtesat	3,662	77	-	(431)	-	-	-	3,308
Mallra dhe shërbime	1,105	-	(105)	-	(105)	-	-	895
Shpenzime komunale	110	-	-	-	-	-	-	110
Transfere dhe subvencione	5	-	(5)	-	-	-	-	0

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Shpenzime kapitale	230	-	-	-	-	-	-	230
Kthimi i huamarrjeve	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjerat	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	5,112	77	(110)	(431)	(105)	-	-	4,543

Më poshtë do paraqesim një shpalosje lidhur me shkurtimet buxhetore dhe kërkesat shtesë nga AKP-ja dhe vendimet e qeverisë përkatësisht vendimi nr. **03/261/, 01/276, 01/281 dhe 04/282** lidhur me kërkesat e parashtruara nga AKP-ja.

Vlera e kursimeve që AKP-ja ka identifikuar dhe deklaruar përmes shkresës drejtuar MFPT-së është **EUR 139,769**. Nga kjo shumë, si kursime janë marrë parasysh vetëm **EUR 109,769**, të realizuara nga dy kategori ekonomike, përkatësisht **EUR 5,000** nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe **EUR 104,769** nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.

AKP-ja nga vlera e përgjithshme ka kërkuar që shuma prej **EUR 30,000**, nga mjetet e kursyera brenda programeve buxhetore të saj, të transferohet në programin buxhetor të Administratës Qendrore, konkretisht në kategorinë ekonomike të shërbimeve komunale. Meqenëse kjo kërkesë nuk është aprovuar nga MFPT-ja, mjetet përkatëse nuk janë bartur dhe, rrjedhimisht, obligimet për faturat e shërbimeve komunale për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor janë bartur si obligime të papaguara dhe janë reflektuar në buxhetin e vitit 2026.

Përveç kursimeve të lartcekura, gjatë periudhës raportuese janë realizuar edhe lëvizje të tjera buxhetore, të cilat kanë rezultuar nga vendime të Qeverisë dhe të cilat paraqiten dhe shpjegohen në vazhdim të pasqyrave financiare.

Mallra dhe Shërbime:

Në kategorinë mallra dhe shërbime buxheti fillestar ka qenë EUR 1,105,000. Me kërkesën e AKP-së dhe vendimeve të marra nga qeveria, kursimet buxhetore në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve kanë vlerën EUR 209,716. Kursimet janë bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe buxheti përfundimtar në këtë kategori ekonomike është EUR 895,283.

Paga dhe Shtesat:

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin fiskal 2025, numri i aprovuar i të punësuarve në AKP është 234 nëpunës, si dhe 8 anëtarë të Bordit të Drejtorëve, gjithsej 242 persona.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në kategorinë ekonomike Pagat dhe Shtesat, buxheti fillestar ka qenë **EUR 3,661,731**. Me Vendim të Qeveris nr. 03/261 të datës 05 qershor 2025, AKP ka pranuar shumën prej **EUR 76,732** si shtesë buxhetore për zbatimin e nenit 33, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-332 për rritjen e dytë prej 0.5 njësi të koeficientit, mirëpo AKP ka reaguar dhe ka njoftuar me shkrim Departamentin e Buxhetit të MFPT meqenëse zyrtaret e AKP-s sipas Ligjit të Pagave përfitojnë shtesën tranzitore dhe rritja e sasisë së koeficientit prej 0.5 (EUR 55.00) reflekton vetëm në disa pozita (stafi mbështetës teknik) dhe në nuk i kemi shfrytëzuar këto mjete.

Ndërkaq, në fund të muajit dhjetor 2025, me vendim të Qeverisë, janë identifikuar kursime buxhetore në këtë kategori nga MFPT-ja në vlerë prej EUR 430,444.00, duke rezultuar në një buxhet përfundimtar prej EUR 3,308,019.00.

Ndërsa në fund të vitit, sipas vendimi të Qeveris Nr. 01/276 të datës 24 dhjetor 2025, MFPT ka reduktuar buxhetin e pagave nga buxheti i Agjencisë shumën prej EUR 430,444.00 .

Në këtë kategori përfshihen pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së, si dhe kompensimi për **8 anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKP-së**.

Shpenzimi total në kategorinë e pagave dhe shtesave për vitin 2025 është **EUR 3,307,537**, që përfaqëson një nivel realizimi prej **99.99%** të buxhetit final. Detajet përkatëse janë të shpalosura në **Shënimin 2.1 – Pagat e Stafit të AKP-së** dhe **Shënimin 2.2** të pasqyrave financiare.

Pagat dhe mëditjet e zyrtarëve të AKP-së, sipas listave të pagave, procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). AKP-ja dorëzon listat e stafit për periudhat përkatëse pranë këtij divizioni, nga i cili realizohen pagesat në llogaritë përkatëse të punonjësve. Pagesat për kontributet e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen drejtpërdrejt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Shpenzimet Kapitale:

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin fiskal 2025, buxheti i aprovuar për shpenzime kapitale ka qenë **EUR 230,000**, ndërsa realizimi i buxhetit në këtë kategori është **23.38%**.

Mjetet kanë qenë të dedikuara për dy projekte kapitale, si më poshtë:

1. **Blerja e pajisjeve të teknologjisë informative (TI) për ngritjen e cilësisë së shërbimeve**
(Kodi i projektit: **18941**), me vlerë të aprovuar EUR 30,000.00. Projekti është realizuar në tërësi dhe teprica e mjeteve të pashpenzuara është EUR 2,429.66.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

2. Data Baza e Arkivës së AKP-së

(Kodi i projektit: **19256**), me vlerë të aprovuar EUR 200,000.00.

Kontrata për projektin “Data Baza e Arkivës së AKP-së” është nënshkruar në vlerë prej EUR 74,850.00. Diferenca prej EUR 125,150.00 është paraqitur pranë MFPT-së si kursim buxhetor, me kërkesë për reduktim nga buxheti i vitit 2025.

Sipas kushteve kontraktuale, realizimi i projektit do të zgjasë 12 muaj, ndërsa pagesat do të realizohen në mënyrë periodike, në përputhje me ecurinë e punimeve të parapara në kontratë. Implementimi i projektit ka filluar më 29 tetor 2025, ndërsa përfundimi dhe pranimi final pritet të realizohet më 28 tetor 2026.

Me datë 12 nëntor 2025, AKP-ja ka njoftuar MFPT-në lidhur me periudhën e implementimit të kontratës dhe ka kërkuar bartjen e buxhetit për këtë projekt në vitin 2026, me qëllim të sigurimit të ekzekutimit të rregullt financiar në përputhje me obligimet kontraktuale.

Gjatë vitit 2025, pagesat e realizuara për këtë projekt janë në vlerë prej EUR 26,197.50, ndërsa pjesa e mbetur EUR 48,652.50 do të realizohet gjatë vitit 2026.

Vlera e kursimeve nga vendimet e Qeverisë për AKP-në për vitin fiskal 2025 sipas kategorive ekonomike është paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

- Ndryshimi buxhetore I - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 03/261 të datës 05/06/2025

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Administrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe shtesa	77	-	-	-	-	-	77
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	77	-	-	-	-	-	77

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

- **Ndryshimi buxhetore II - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 01/276 datës 24/11/2025**

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrate Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe shtesa	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	-	(5)	(4.5)	(2.5)	(19.4)	(73.3)	(104.7)
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	(5)	-	-	(5)
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	-	5	4.5	7.5	19.4	73.3	109.7

- **Ndryshimi buxhetore III - sipas vendimit të Qeverisë me nr.**

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrate Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	(431)	-	-	-	-	-	(431)
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	431	-	-	-	-	-	431

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

- Ndryshimi buxhetore IV - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 04/282 të datës 26/12/2025

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrate Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	(49)	-	-	-	(53)	(3)	(105)
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	49	-	-	-	53	3	105

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 2 PAGA DHE SHTESAT

	2025					2024	2023
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final	Ndryshimi Buxheti - Pagesat		
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave	1,558	1,558	-	1,558	-	1,420	2,832
Shtesat Tranzitore	978	978	-	978	-	1,190	-
Përvoja e punës për stafin e AKPs	109	109	-	109	-	94	-
Funksionar me kohë të pjesshme	139	139	-	140	1	219	214
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	215	215	-	215	-	231	249
Kontributi pensional-punëtori	151	151	-	151	-	155	162
*Vendim Gjyqësorë	5	5	-	5	-	-	-
Kontributi pensional-punëdhënësi	151	151	-	151	-	155	162
Shtesa për kushte të tregut të punës	1	1	-	1	-	3	-
PAGA DHE Shtesa -	3,307	3,307	-	3,308	1	3,467	3,620

***Në Tetor 2024 Zyrtari N.I.** kishte deponuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës (KPMShCK) për mos aplikimin e shtesës për kushte të tregut, në pagë. Kërkesa është në vlerë prej 250 Euro në muaj - nga muaji Prill 2023 deri në pagesën definitive. Sipas vendimit të KPMShCK, ankesa i ishte aprovuar zyrtarit në fjalë për pagesën prej EUR 250.00 në muaj nga Prill 2023 deri në Maj 2025. Ngjarja ishte parashikuar dhe shpalosur edhe si detyrim kontigjentë në PF 2024.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË dhe Buxheti shtesë në kategorinë e pagave për vitin fiskal 2025

Numri i punëtorëve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2025 është 242 (234 nëpunës dhe 8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve). Detajet janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 25.

Po ashtu në numrin e përgjithshëm të punëtorëve të buxhetuar janë të përfshirë edhe 8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Detajet janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 2.2.

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë Divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Shpenzimet për paga dhe shtesa përfshijnë pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së si dhe kompensimin e 8 anëtarëve të bordit të AKP-së.

Në kategorinë paga dhe shtesa buxheti fillestar ka qenë **EUR 3,661,731** ndërsa ai përfundimtar është **EUR 3,308,019**. Diferenca e shumës prej **EUR 353,711**, MFPT në kategorinë e pagave dhe shtesës ka arritur si rezultat i dy vendimeve të Qeverisë së Kosovës:

Vendimi i Qeverisë me NR. 03/261 të datës 05 qershor 2025, AKP ka pranuar shumën prej EUR 76,732 si shtesë buxhetore për zbatimin e nenit 33, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-332 për rritjen e dytë prej 0.5 njësi të koeficientit, mirëpo AKP ka reaguar dhe ka njoftuar me shkrim Departamentin e Buxhetit të MFPT meqenëse zyrtaret e AKP-s sipas Ligjit të Pagave përfitojnë shtesën tranzitore dhe rritja e sasisë së koeficientit prej 0.5 (EUR 55.00) reflekton vetëm në disa pozita (stafi mbështetës teknik) dhe në nuk i kemi shfrytëzuar këto mjete.

Ndërsa në fund të vitit, sipas vendimi të Qeverisë Nr. 01/276 të datës 24 dhjetor 2025, MFPT ka reduktuar buxhetin e pagave nga buxheti i Agjencisë shumën prej EUR 430,444.00 .

Shpenzimet për Pagat Bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së për vitin 2025 janë gjithsej **EUR 3,168,274**. Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komitetin Auditimit dhe Komisionit për vlerësim të performancës së Menaxhmentit për vitin 2025 është në vlerën **EUR 138,476**. Ndërsa, **EUR 787.00** janë shpenzime e angazhimit të ekspertëve të jashtëm të angazhuar si anëtar të komisionit sipas Ligjit për rekrutimin e pozitave të larta. Kompensimi dhe Kontributet e pagesave të Bordit dhe të komisioneve janë realizuar nga kodi ekonomik "Funksionarët me kohë të pjesshme" (11441).

Gjithsej shpenzimi i buxhetit në kategorinë e pagave është **EUR 3,307,537**. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 99.99%.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

LËVIZJET E STAFIT:

- **REKRUTIMET:** Gjatë kësaj periudhe, Divizioni i Burimeve Njerëzore (DBNJ) ka udhëhequr me njëmbëdhjetë (11) procedura të rekrutimit, prej tyre dhjetë (10) janë në procesin si me poshtë:
 - Dy (2) procese janë në vazhdim dhe aktualisht ndodhen në fazën e verifikimit paraprak.
 - Një (1) proces ka përfunduar me sukses.

Tetë (8) procese janë anuluar, si në vijim:

- Dy (2) procese janë anuluar me vendim të KPMSHC;
- Një (1) proces ka dështuar pasi kandidati nuk është paraqitur në intervistë;
- Dy (2) procese janë anuluar për shkak të gabimeve teknike;
- Dy (2) procese janë anuluar për shkak të problemeve në sistem;
- Një (1) proces është anuluar për shkak të skadimit të mandatit të Bordit të Drejtorëve.

Lista e proceseve:

- **Drejtor Ekzekutiv** – anuluar me vendim të KPMSHC për shkak të ankesës së një kandidati
- **Zyrtar Kadastral, ZR Prizren (Rishpallje III – RN00016519)** – ka dështuar pasi vetëm një (1) kandidat ka kaluar testimin me shkrim dhe nuk është paraqitur në intervistë
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt – Kadastër** – ka përfunduar me sukses
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt** – anuluar me vendim të KPMSHC për shkak të ankesës së një kandidati
- **Drejtor Ekzekutiv (Rishpallje – RN00018306)** – anuluar për shkak të skadimit të mandatit të Bordit të Drejtorëve
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt (Rishpallje – RN00018930)** – anuluar për shkak të lëshimit teknik
- **Zyrtar i Zyrës Rajonale, ZR Prishtinë (RN00018931)** – anuluar për shkak të lëshimit teknik
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt (Rishpallje – RN00018940)** – anuluar për shkak të punimeve në rrjetet softuerike të sistemit të ASHl
- **Zyrtar i Zyrës Rajonale, ZR Prishtinë (Rishpallje – RN00018939)** – anuluar për shkak të punimeve në rrjetet softuerike të sistemit të ASHl
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt (Rishpallje – RN00019105)** – në proces
- **Zyrtar i Zyrës Rajonale, ZR Prishtinë (Rishpallje – RN00019106)** – në proces

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

- **DORËHEQJE:** Për arsye personale tre (3) punonjës kanë dhënë dorëheqje.
- **TRANSFERET E PËRHERSHME:** Tre (3) punonjës janë transferuar në mënyrë të përhershme.
- **TRANSFERET E PËRKOHSHE:** Njëzet (20) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme, prej tyre (pesë) 5 janë caktuar në vitin 2024 me afat deri në vitin 2025
- **PEZULLIM I DAKORDUAR:** Gjashtë (6) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.
- **PUSHIM LEHONIE:** Katër (4) zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë, prej të cilave tre (3) punonjëse pushimin e lehonisë e ka filluar në vitin 2024.
- **PENSIONIME:** Shtatë (7) nëpunës janë pensionuar.
- **PENSIONIM TE PARAKOHSHEM:** Tre (3) nëpunës kanë shfrytëzuar pensionimin e parakohshëm;
- **ZËVENDËSIMET:** Tetë (8) pozita janë zëvendësuar nga zyrtar të caktuar në periudha të ndryshme. Pesë (5) prej tyre janë caktuar në vitin 2024 me afat deri në vitin 2025.

Si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të strukturës organizative e AKP-së e cila ka hyrë në fuqi nga data 1 tetor 2023, janë shuar 5 departamente dhe 7 njësi (divisione). Numri i zyrtarëve që ju është shuar pozita është (shtatë) 7. Prej tyre, (4) zyrtar janë sistemuar në pozita ekuivalente brenda AKP-së, ndërsa në mungesë të pozitave të lira, (tre) 3 zyrtar janë ende në listë të pritjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil (KPMSHC), me vendimin nr. A 1406/2023, ka konstatuar se procesi i ristrukturimit në AKP ka filluar sipas nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për ZP, sipas të cilit AKP obligohet ti transferojë shërbyesit civil në pozitë tjetër të sh. civil të së njëjtës kategori. Ndërsa, pozita të së njëjtës kategori nuk ka.

KPMSHC, gjithashtu, me vendimin nr. A.nr.556/2023 i, konstaton se “nëpunësit civil sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuar apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori.

Lidhur me çështjen në fjalë, Agjencia ka bërë përpjekje të zgjidhë këtë çështje përmes Departamentit për Menaxhim të Zyrtarëve Publik (DMZP) të Ministrisë së Punëve të Brendshme duke kërkuar nga DMZP të bëjë sistemin e 3 (tre) zyrtarëve të listës në pritje në institucione tjera shtetërore.

DMZP ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se nuk është përgjegjëse për sistemin e zyrtarëve të institucioneve të pavarura siç është AKP. Sidoqoftë, lidhur me sistemimin e nëpunësve civil, neni 67 paragrafi 2 i Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publik, përcakton se:

“Ministria përgjegjëse për administratë publike, kujdeset për sistemimin e nëpunësve civil në pritje në kategori të njëjtë të shërbimit civil, si dhe trajnimin për pozitën përkatëse ku sistemohet”.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË Kodi: “Funksionarët me kohë të pjesshme” (11441)

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat 4 vjeçar dhe kompensohet sipas Rregullores për Kompensimin e Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Për periudhën raportuese Bordi i drejtorëve është përbë vetëm nga 7 anëtarë. Pagesat në vlerën prej EUR 106,904.40 të realizuara nga kodi “funksionar me kohë të pjesshme” ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së. Për anëtarët për komisione shuma në vlerë prej EUR 7,301.25 dhe raste tjera në vlerë prej EUR 641.25 për ekspertet e jashtëm të angazhuar në komisione për rekrutim të kandidatëve, po ashtu shuma prej EUR 12,760.82 janë pagesa të realizuara kundrejt Administratës Tatimore dhe shuma në vlerën prej EUR 11,655.76 janë pagesa të realizuara Trustit Pensional të cilat pasqyrohen si më poshtë:

		1	2	3	4=1+2+3
Nr.	Përshkrimi	Pagesat neto	Tatimet	Kontributet pensionale (5+5%)	Gjithsej
1	Për mbledhje të Bordit	106,905	11,878	10,806	129,589
2	Për komisionet e Bordit	7,301	811	775	8,887
3.	Për ekspertët e jashtëm	641	71	75	787
	Gjithsej	114,847	12,760	11,656	139,263

Pagesat e realizuara gjatë periudhës raportuese lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së gjatë vitit 2025 dhe janë paraqitur si më poshtë:

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, në gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2025 ka funksionuar me kapacitet të kufizuar për shkak të skadimit të mandateve të shumicës së anëtarëve të Bordit. Konkretisht, gjatë këtij viti Bordi ka pasur vetëm 7 anëtarë aktivë. Nga data 05 gusht 2025, Bordi ka mbetur pa kuorum funksional, si pasojë e përfundimit të mandatit të pesë (5) anëtarëve. Në këtë periudhë, vetëm dy (2) anëtarë me mandat valid, z. Mentor Hyseni dhe z. Gent Nushi, kanë mbetur pjesë e Bordit. Megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit ligjor, nga kjo datë nuk ka qenë e mundur mbajtja e mbledhjeve të Bordit, pasi për zhvillimin e tyre kërkohet prania e së paku pesë (5) nga gjithsej tetë anëtarë.

Nga data 13 gusht 2025, z. Mentor Hyseni ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryesuesit të Bordit, duke bërë që gjatë pjesës së mbetur të vitit 2025, z. Gent Nushi të jetë i vetmi anëtar me mandat aktiv në Bordin e Drejtorëve.

**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Gjatë periudhës kur Bordi ka qenë funksional, janë mbajtur gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) mbledhje të Bordit:

- Komiteti i Auditimit ka qenë funksional gjatë gjithë vitit fiskal 2025. Në kuadër të përgjegjësisë së tij, ky komitet ka mbajtur gjithsej 6 (gjatë) takime, si dhe ka pasur angazhime të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës raportuese, për të cilat janë realizuar pagesat përkatëse.
- Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Menaxhmentit gjatë vitit 2025 ka mbajtur gjithsej 6 (gjashtë) takime. Megjithatë, nga muaji qershor 2025, ky komision ka pushuar së funksionuari dhe, rrjedhimisht, nga kjo periudhë nuk janë proceduar pagesa për anëtarët e këtij komisioni.

Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komitetit të Auditimit, Komisionit për vlerësim të performancës së Menaxhmentit dhe komisione të jashtme për rekrutim për vitin 2025 është në vlerën **EUR 139,263**.

SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME

Shumat e paraqitura në tabelën e mallrave dhe shërbimeve janë financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Më poshtë janë paraqitur dhe shpalosur në detaje shënimet lidhur me natyrën e shpenzimeve.

Përshkrimi	2025				Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	2024	2023
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		€ '000	€ '000
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Mëditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Akomodimi për udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet tjera për udhëtime zyrtare brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e tjera e udhëtimit zyrtare jashtë vendit	-	-	-	-	-	1	-
Shpenzimet për internet	4	4	-	4	-	4	6
Shpenzimet e telefonisë mobile	19	19	-	20	1	20	17
Shpenzimet postare	2	2	-	2	-	2	1
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	8	8	-	9	1	9	6
Sigurimi fizik i objekteve publike	266	266	-	267	1	267	-
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	-	-	-	-	-	-	2
Shërbime shtypje - jo marketing	5	5	-	6	1	3	-

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Shërbime Kontraktuese Tjera	72	72	-	72	-	52	319
Shërbime Teknike	-	-	-	-	-	-	-
Mobile (me pak se 1000 euro)	5	5	-	6	1	1	5
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	9	9	-	9	-	28	-
Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	10	10	-	10	-	5	6
Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	8	8	-	8	-	1	14
Furnizime për zyrë	5	5	-	5	-	8	33
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	6	6	-	6	-	8	9
Furnizime pastrimi	11	11	-	11	-	7	11
Furnizim me veshmbathje	-	-	-	-	-	-	-
Naftë për ngrohje qendrore	17	17	-	17	-	4	14
Derivate për automjete, gjenerator dhe makineri	22	22	-	38	16	28	23
Vaj	-	-	-	-	-	-	-
*Avance	-	-	-	-	-	-	1
Regjistrimi i automjeteve	2	2	-	2	-	2	2
Sigurimi i automjeteve	7	7	-	7	-	8	8
Taksa komunale e regjistrimit të automjeteve	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	21	21	-	21	-	19	26
Mirëmbajtja e ndërtesave	-	-	-	-	-	1	1
Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste	2	2	-	2	-	1	22
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	62	62	-	67	5	34	16
Qiraja për ndërtesa	87	87	-	88	1	92	104
Qiraja për pajisje	1	1	-	2	1	1	-
Qiraja për përdorime tjera hapësinore	103	103	-	104	1	178	188
Softuerët licencat dhe mirëmbajtja e tyre	38	38	-	39	1	22	-
Qiraja për automjete	5	5	-	5	-	22	-
Botimet e publikimeve	4	4	-	4	-	-	-
Shpenzimet për informim publik	33	33	-	56	23	63	39
Drekat zyrtare	7	7	-	8	1	8	6

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Shpenzime-vendimet e gjykatave	-	-	-	-	-	25	-
MALLRA DHE SHËRBIME	841	841	-	895	54	924	879

- *Avanci buxhetor për paratë e imëta që është mbajtur në arkë.* Të gjitha pagesat e bëra deri në vlerën prej **EUR 500.00**, gjatë vitit fiskal 2025, janë kategorizuar sipas planit kontabël, gjendja në fund të vitit, ashtu siç kërkohet me procedura është mbyllur dhe është zero.

3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME

Në kategorinë mallra dhe shërbime buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) në kategorinë mallra dhe shërbime është **EUR 1,105,000** ndërsa ai përfundimtar **EUR 895,283**.

Diferenca prej EUR 209,716.78 është rezultat kursimeve buxhetore të cilat AKP i ka paraqitur pranë MFPT-së vendimet e Qeverisë me Nr. 01/276 dhe 04/282 . Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 93.90%.

Gjithsej mbetja e buxhetit të pasheqeruar (pas kurimeve) për vitin 2025 është EUR 54,598.45.

Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime kanë qenë të destinuara:

- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative;
- Për të mbuluar shpenzimet e procesit të Privatizimit dhe Likuidimit;
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit;

Në tremujorin e fundit të vitit 2025, në kategorinë mallra dhe shërbime kemi identifikuar kursime buxhetore në vlerë prej EUR 209,716.78 të cilat, gjatë përmbylljes së vitit fiskal, i kemi paraqitur pranë MFPT-së dhe njëkohësisht kemi kërkuar që mjetet e kursyera të reduktohen nga buxheti i Agjencisë.

Në renditjen e mëposhtme janë shpalosur disa nga linjat më relevante në të cilat ka pasur shpenzim më të ulët se sa planifikimi fillestar:

- Derivate dhe lëndë djegëse (naftë për ngrohje qendrore, derivate për gjenerator, karburant dhe vaj për vetura;
- Blerjet tjera furnizime për zyre, furnizim me ushqim dhe pije dhe furnizim me veshmbathje
- Mirëmbajtja e ndërtesave, mobileve dhe pajisjeve;
- Shpenzimet për informim publik,
- Licencave dhe softuerëve mirëmbajtja e tyre.

Shumat e teprcës së buxhetit të pa shpenzuar janë të shpalosura te pasqyrat financiare të programeve përkatëse buxhetore.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE

	2025					2024	2023
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final	Ndryshim i Buxheti - Pagesat	Pagesat	Pagesat
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Rryma	55	55	-	55	-	53	45
Uji	2	2	-	2	-	1	1
Mbeturinat	4	4	-	4	-	4	3
Ngrohja Qendrore	46	46	-	46	-	44	29
Shpenzimet telefonike	4	4	-	4	-	4	4
Pagesa-vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-
SHPENZIMET KOMUNALE	110	110	0	110	-	106	82

Për periudhën raportuese, buxheti fillestar i aprovuar për shërbime komunale ka qenë **EUR 110,000** dhe buxheti final është **EUR 110,000** financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 99.84%. Buxheti i pa shpenzuar është EUR 176.55.

AKP-ja në kërkesën buxhetore për vitin 2025 ka planifikua buxhet në vlerë EUR 110,000 për këtë kategori ekonomike mirëpo vlerësimet aktuale kanë treguar se kjo shumë nuk ishte e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet deri në përmbylljen e vitit fiskal.

Arsyeja kryesore e mungesës së mjeteve është rritja e çmimit të energjisë elektrike prej 16%, që ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove mujore të shërbimeve komunale. Gjithashtu, duke u bazuar në faturat e muajve janar–shkurt 2025 të shërbimit të ngrohjes qendrore, të lëshuara nga Termokos, rezulton se edhe për ngrohje qendrore mjetet ishin të pamjaftueshme.

Kërkesa për buxhetin shtesë në kategorinë e shërbimeve komunale ka qenë 30,000 EUR. Kjo shumë është kërkuar të sigurohet përmes transferit nga kursimet buxhetore të identifikuar dhe të raportuara nga AKP-ja gjatë periudhës tremujorit të fundit. Për këtë qëllim, AKP-ja ka adresuar disa shkresa zyrtare, si dhe ka realizuar kontakte të vazhdueshme me shkrim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me qëllim të aprovimit të kërkesës për buxhet shtesë në këtë kategori ekonomike. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të bëra dhe dokumentacionit të dorëzuar, MFPT nuk e ka

**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

aprovuar kërkesën për buxhet shtesë në kategorinë e shërbimeve komunale. Si pasojë e mos aprovimit të kësaj kërrese, ne nuk kemi pasur mundësi të mbulojmë në mënyrë të plotë të gjitha obligimet financiare të krijuara gjatë këtij vitit fiskal në këtë kategori ekonomike. Për rrjedhojë, shuma e faturave të papaguara për këtë vit në kategorinë e shërbimeve komunale është e konsiderueshme, duke krijuar obligime të bartura për periudhën e vitit fiskal 2026.

Pjesa më e madhe e faturave të paraqitura si obligime në tabelë e detyrimeve Neni 17. janë pranuar gjatë muajit janar 2025, mirëpo janë edhe disa fatura të shërbimeve komunale të cilat për shkak të mungesës së mjeteve janë pranuar edhe gjatë muajit nëntor por janë bartur si obligime për arsyet e ditura.

Shuma totale e këtyre obligimeve EUR 26,304.38.

SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

	2025					2024	2023
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final	Ndryshimi Buxheti - Pagesat	Pagesat	Pagesat
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Subvencione për entitetet publike	-	-	-	-	-	-	-
Subvencionet për entitetet publike (tea.bib)	-	-	-	-	-	-	-
Subvencione për entitetet jopublike	-	-	-	-	-	-	-
Menaxhimi i burimeve të ujitjes për bujqësi	-	-	-	-	-	-	-
Diversifikimi i fermave	-	-	-	-	-	-	-
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	-	-	-	-	-	-	-

Për periudhën raportuese, buxheti i fillestar për subvencione dhe transfere është **EUR 5,000**, dhe buxheti final është **EUR 0.00**, financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Buxheti ka qenë i planifikuar për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit. Mjetet nga Subvencionet janë paraparë që të shfrytëzohen për pagesën e

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

menaxhmentit dhe drejtorëve të bordeve menaxhuese të Ndërmarrjeve në Administrim Direkt, të cilat nuk kanë mundësi për të bërë pagesën nga mjetet që realizojnë ndërmarrjet.

Edhe këtë vit fiskal AKP për të mos shfrytëzuar buxhetin e Kosovës për çështje të NSh-ve, ka shfrytëzuar mjetet të cilat janë akumuluar në llogaritë e këtyre NSh-ve apo për ato NSh që nuk kanë të hyra është shfrytëzuar përkohësisht mjetet nga llogaria e Tarifës Administrative.

Andaj, buxheti i aprovuar nuk ka mundur të shpenzohet dhe si i tillë është identifikuar si kursim buxhetor ku gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin nëntor kemi kërkuar nga MFPT të reduktohet nga buxheti i Agjencisë, andaj buxheti përfundimtar nga kjo kategori ekonomike është 0.00.

SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE

	2025				2024	2023
	Gjithsej Pagesat	Buxheti Final				
		GQ	THD		Ndryshimi Buxheti - Pagesat	Pagesat
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pajisje të teknologjisë informative dhe komunikimit	28	28		30	2	4
Softver	27	27		200	173	6
Pasuri e paprekshme	-	-		-	-	9
Pajisje tjera	-	-		-	-	37
Shpenzime kapitale	54	54	0	230	176	56
						13

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar fillestar për shpenzime kapitale ka qenë **EUR 230,000**, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Mjetet kanë qenë të destinuara për dy projekte kapitale:

1. Blerja e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë së shërbimeve (Kodi i projektit 18941), vlera EUR 30,000.00. Projekti është realizuar në vlerën prej EUR 27,570.34 dhe teprica e shumës së pa shpenzuar është EUR 2,429.66.
2. Data baza e arkivës së AKP-së (kodi i projektit 19256), vlera EUR 200,000.00 dhe realizimi i këtij projekti pasqyrohet si më poshtë:

**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, kohëzgjatja e realizimit të këtij projekti është 12 (dymbëdhjetë) muaj, ndërsa pagesat do të realizohen në mënyrë periodike, në përputhje me dinamikën e realizimit të punëve dhe obligimeve të parapara kontraktuale. Implementimi i projektit ka filluar më 29 tetor 2025, ndërsa përfundimi i plotë dhe pranimi final i projektit, sipas kushteve të kontratës, është paraparë të bëhet më 28 tetor 2026. Me qëllim të sigurimit të një ekzekutimi të rregullt financiar dhe përmbushjes së obligimeve kontraktuale gjatë vitit 2026, AKP më 12 nëntor 2025 ka paraqitur kërkesë zyrtare pranë MFPT-së për bartjen e buxhetit në vitin 2026, për pjesën e mbetur të vlerës së kontratës në shumë prej EUR 48,652.50. Gjatë vitit 2025, për këtë projekt janë realizuar pagesa në vlerë totale prej 26,197.50 EUR, ndërsa pjesa e mbetur e pagesave do të realizohet gjatë vitit 2026, në përputhje me progresin e projektit dhe afatet e përcaktuara kontraktuale. Si rezultat i realizimeve të bëra deri në fund të vitit 2025, realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori ekonomike është 23.38%.

SHËNIMI 7 TJERA

AKP-ja pranon depozitat e ofertuesve për pjesëmarrje në tender si depozitë e sigurisë. Këto mjete kthehen në rastin kur këta ofertues nuk janë fitues. Rastet kur ofertuesit janë fitues të përkohshëm mirëpo nuk arrijnë t'i plotësojnë kriteret tjera si p.sh. realizimin e pagesës të shumës blerëse brenda afatit kohor, depozitat e tyre konfiskohen dhe njihen si të hyra. Rastet e tilla paraqiten si të hyra në *nr. 10 të shënimeve shpjeguese*.

Detaje lidhur më këto të Hyra janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

	2025	2024	2023
Natyra e pagesës	€ '000	€ '000	€ '000
Depozitat e lojërave të fatit	0	0	0
Depozitat e Komisionit Rregullativ	0	0	0
Depozitat e Ministrisë së Drejtësisë	0	0	0
Depozita tjera	0	0	0
Gjithsej	0	0	0

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE

Nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të Agjencisë.

		2025	2024	2023		
Përshkrimi	Shënime	€ '000	€ '000	€ '000	% e totalit nga 2021	% e ndryshimit nga 2022
Të hyrat tatimore 1						
Të hyrat tatimore 2						
Të hyrat tatimore 3						
Të hyrat tatimore 4						
GJITHSEJ						

SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE

		2025	2024	2023	% e totalit nga 2023	% e ndryshimit nga 2022
Përshkrimi	Shënime	€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat nga shitja e mbeturinave				1		
Të hyrat nga dënimet-gjoha						
Të hyrat nga licencat						
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve						
Të hyrat nga inspektimi						
Të hyrat nga interesi bankar						
Të hyrat nga ndryshimi i pozicionit të kursit						
Të hyrat nga pasuria						
GJITHSEJ				1		

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 10 TË ARDHURAT E DEDIKUARA

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080:

Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqindje (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë.

10.1. TË ARDHURAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të detajuar shumat e transferuara nga buxheti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për periudhën 2011–2019. Këto shuma janë sipas vlerave të buxhetuara dhe të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për secilin vit fiskal. Deri më tani, totali i fondeve të transferuara për këto qëllime arrin në EUR 45,777,947, çka paraqet një kontribut të konsiderueshëm në sigurimin e vazhdimësisë dhe efikasitetit të operimit të AKP-së gjatë kësaj periudhe.

NR.	PËRSHKRIMI DHE DATA E TRASFERËVE	PËR BUXHETIN E VITIT	GJITHSEJ
1	Transfer gjatë vitit 2011	2011	1,800,000
2	Transfer me 28 Maj 2012	2012	8,200,000
3	Transfer me 28 Dhjetor 2012	2013	8,048,000
4	Transfer shtesë me 18 Nëntor 2012	2014	2,300,000
5	Transfer shtesë me 15 Janar 2015	2015	5,500,000
6	Transfer shtesë me 15 Janar 2016	2016	6,300,000
7	Transfer shtesë me 20 Janar 2017	2017	6,100,000
8	Transferet shtesë gjatë vitit 2018	2018	6,493,706
9	Transferet shtesë gjatë vitit 2019	2019	1,036,241
10	Transferet shtesë gjatë vitit 2020-2025	2020-2025	0.00
GJITHSEJ PAGESAT			45,777,947

Lidhur me bartjen e tepricave dhe transferimin e mjeteve shtesë për buxhetin e të hyrave të dedikuara për më tepër, shih shënimin shpjegues nr. 23.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Për vitin 2025, buxheti i AKP-së është financuar tërësisht nga Granti Qeveritar. Rrjedhimisht siç është paraqitur në tabelën më lartë nuk kemi transferuar mjete apo nuk kemi financim nga të hyrat e dedikuara.

Mjetet e paraqitura që janë shpalosur më lartë, nga pika katër deri në nëntë, janë transferuar vetëm për ato shuma shtesë të nevojshme për të mbuluar buxhetin e periudhës fiskale, pasi që kemi pasur mjete të pa shpenzuar dhe këto mjete sipas Ligjit të Buxhetit dhe të AKP-së

AKP-ja nuk planifikon të hyra si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Thesari i Ministrisë së Financave është kërkuar që të paraqitet si e hyrë vetëm transferi bankar në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit.

Shpalosja e të hyrave nga Fondet në Mirëbesim janë të paraqitura në detaje te Pasqyrat Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar Grante nga Donatorët.

			2025	2024	2023
			€ '000	€ '000	€ '000
Përshkrimi					
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	0.00	0.00	0.00
Gjithsej			0.00	0.00	0.00

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIME TJERA 12

Agjencia nuk është e përfshirë në pranim të depozitave të natyrave tjera.

	2025	2024	2023
	€ '000	€ '000	€ '000
Natyra e pranimi			
Depozitat e lojërave të fatit	0	0	0
Depozitat e Komisionit Rregullativ	0	0	0
Depozitat e Ministrisë së Drejtësisë	0	0	0
Depozita tjera	0	0	0
Gjithsej	0	0	0

SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA

Agjencia nuk është e përfshirë në pranim të depozitave të natyrave tjera.

	2025	2024	2023
	€ '000	€ '000	€ '000
Natyra e pranimi			
Pagat dhe mëditjet	0	0	0
Mallrat dhe Shërbimet	0	0	0
Shpenzimet Komunale	0	0	0
Subvencione dhe Transferet	0	0	0
Gjithsej pagesa nga palët e treta	0	0	0

Neni 16 TË ARKËTUESHMET

		2025	2024	2023
Kodi ekonomik	Përshkrimi	€	€	€
0000	Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobilë	0.00	0.00	0.00
	GJITHSEJ	0.00	0.00	0.00

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	2025		2024		2023	
		< 30 ditë	> 30 Ditë	< 30 ditë	> 30 Ditë	< 30 ditë	> 30 Ditë
11	Paga dhe Shtesa	658.03	-	250	-	-	-
13	Mallra dhe shërbime	32,063.51	1,913.20	41,841.42	994.00	44,349.63	3,084.35
14	Shpenzime komunale	26,304.38		13,188.82	-	12,100.12	-
20	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-
30	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		59,025.92	1,913.20	55,280.24	994.40	56,449.75	3,084.35

Në shumat e obligimeve të papaguara janë të paraqitura sipas datës së pranimit të faturave, për të cilat është raportuar në Thesar të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve si dhe për shpenzimet e vitit 2025 dhe shuma totale e obligimeve është **EUR 60,939.12**. Të dhënat detaje janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 3.

Pjesa më e madhe e faturave të paraqitura si detyrime në tabelë janë pranuar gjatë muajit janar 2026, me përjashtim të disa faturave të shërbimeve komunale, të cilat për shkak të mungesës së mjeteve janë pranuar edhe gjatë muajit dhjetor por janë bartur si obligime për arsyet e ditura. Mungesa e mjeteve në këtë kategori ekonomike ka ardhur si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë elektrike prej 16%, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove mujore të shërbimeve komunale. Po ashtu, bazuar në faturat e muajve janar–shkurt 2025 për shërbimin e ngrohjes qendrore, të lëshuara nga Termokos, rezulton se mjetet e planifikuara për ngrohje qendrore kanë qenë të pamjaftueshme.

Një pjesë e faturave janë pranuar pas përfundimit të afatit për pagesa (24 dhjetor 2025), afat ky i përcaktuar nga Departamenti i Thesarit pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Gjatë muajit janar 2026, AKP-së i janë alokuar vetëm 2/12 e mjeteve buxhetore, në përputhje me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025. Si rrjedhojë, deri në periudhën e dorëzimit të pasqyrave financiare, gjendja e obligimeve ka ndryshuar duke rezultuar në zvogëlimin e tyre. Shuma e paguar deri në datën 27 janar 2026 është EUR 35,382.19 dhe mund të pësoj ndryshime deri në datën e dorëzimit të pasqyrave financiare.

Faturat që kanë kaluar afatin e pagesës prej mbi 30 ditësh janë gjithsej 11 fatura, të cilat i përkasin viteve 2020 - 2025. Për këto raste, operatorët ekonomikë nuk janë përgjigjur ndaj kërkesave tona për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm (regjistrimi i furnitorit dhe dorëzimi i faturës), gjë që ka pamundësuar procedimin e pagesave. Për këtë arsye, gjatë vitit 2026, do të angazhohen menaxherët e këtyre kontratave për të kontaktuar edhe një

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

herë furnitorët përkatës, me qëllim të sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe gjetjes së një zgjidhjeje përfundimtare. Kjo do të bëhet duke marrë parasysh se shuma e këtyre faturave është e vogël dhe në mënyrë që këto obligime të mos barten në vitet e ardhshme.

Neni 18 DETYRIMET KONTINGJENTE

Detyrimet kontingjente të AKP-së të cilat kanë të bëjnë me: Kategorinë Ekonomike të Pagave dhe Shtesave.

		2025	2024	2023
	Kategoritë ekonomike	€ '000	€ '000	€ '000
11	Pagat dhe shtesa	4,015,692	2,826,830	1,649,438
13	Mallrat dhe shërbimet	0	0	0
14	Shërbimet komunale	0	0	0
20	Subvencione dhe Transferet	0	0	0
30	Shpenzimet kapitale	0	0	0
	Gjithsej	4,015,692	2,826,830	1,649,438

Rrjedha e ndryshimeve gjatë vitit 2025 është sipas tabelës të mëposhtme:

PËRSHKRIMI	Vlera
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 Dhjetor 2024	2,826,830
1. Në muajin shtator 2019, Drejtori Menaxhues kishte nxjerr vendim për 4 vozitës për ngritje të hapit nga 6-11 në 6-9. Departamenti i Burimeve Njerëzore, ka kërkuar nga ish Menaxhmenti rishikimin e këtij vendimi, pasi që ky vendim nuk ka gjetur zbatim nga Ministria e Administratës Publike. Vlera total EUR 14,946 kurse vlera e azhurnuar për vitin 2025 EUR 1,342	+ 1,342
2. Lënda A.nr.2245-2020, padia e punëtorët për ndryshim të hapit nga 5-8 në gradën 5-4. Gjykata Themelore e ka refuzuar padinë e palës, dhe se pala ka paraqitur ankesë në shkallën e dytë. Edhe shkalla e dytë, me datën 30 janar 2025 e ka refuzuar ankesën/	- (12,480)
Lidhur me ankesën e punëtorëve për zbritjen e pagave sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve nga periudha 1 janar 2023 – 31 dhjetor 2025. Përshkrimi i gjithë ngjarjes është në shënimin shpjegues nr. 18.2. Vlera total EUR 2,400,000 kurse vlera e azhurnuar për vitin 2025 EUR 1,200,000	+ 1,200,000
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 dhjetor 2025	= 4,015,692

*Lista detaje e detyrimeve është shpalosur në aneksin e pasqyrave financiare 2025 – tabela neni 18 – Detajet.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Lista e detyrimet kontingjente të shpalosura vetëm si shënim

Përshkrimi	2025	2024
Rasti kontest pune, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, lënda C.nr.3822/2019, ankesa për kthim në punë dhe kompensim të pagave nga data 1 janar 2011 deri në ditën e kthimit.	shënim	shënim
Në emër të pagave të papaguara për periudhën sa ka qenë në pezullim parandalues. Drejtori Ekzekutiv me vendimin DM 174/2023 të datës 04 maj 2023 ka refuzuar kërkesën e A.A. për kompensim në emër të pagave të pa paguara. Pala ka informuar se ka bërë ankesë në Gjykatë.	shënim	shënim
Padia e kolegëve R.F dhe G.A, lidhur me kamatën ligjore 8% nga data e suspendimit deri në datën e kthimit në AKP. Dy nëpunësve ju është bërë pagesa e 50% të ndalesës sa kanë qenë në suspendim sipas vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Prishtinë më datë 15 nëntor 2021 me nr. 130/16. Palët janë ankuar edhe për pagesën e 8% të kamatës ligjore. Gjykata e shkallës të parë e ka hedhur poshtë. Çështja është në shkallën e dytë.	shënim	shënim
Në Tetor 2024 Zyrtari N.I. ka deponuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës (KPMSHCK) për mos aplikimin e shtesës për kushte të tregut, në pagë. Kërkesa është në vlerë prej 250 Euro në muaj - nga muaji Prill 2023 deri në pagesën definitive. KPMSHCK ka shqyrtuar ankesën, dhe ka lëshuar Vendim në favor të palës dhe është paguar në vlerën prej EUR 250.00 në muaj nga 1 prill 2023 – 31 maj 2025.	Fshirë 2025	shënim
Lënda A nr. 3062 - 2021, Gjykata Themelore PR. Zyrtarja N. K. ka ushtruar padi duke kërkuar anulimin e Vendimit të KPMSHC dhe kërkon që të obligohet Agjencia të bëjë kompensimin e pagave për periudhën 31.10.2019 deri më 01.07.2021.	Shënim	shënim

18.1 Shpalosje lidhur me pasigurinë e ngjarjes në të ardhmen varësisht nga vendimi i Gjykatës

Kontesti administrativ i iniciuar nga stafi i AKP-së ndaj vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, sipas padisë A.nr.2993/2022, ndaj vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së për uljen e pagave të zyrtarëve të Agjencisë.

18.1.1. Historiku i ngjarjes lidhur me kontestin administrativ

Bordi i Drejtorëve të AKP-së me vendimin nr. BD-153/9 të datës 29.10.2021 ka marrë vendim për plotësim dhe ndryshim të Rregullores të Pagave për stafin e AKP-së. Qëllimi i plotësim/ndryshimit të Rregullores të Pagave ishte zbritja e pagave për gjithë stafin e saj. Pas këtij vendimi, një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të AKP-së kishin dorëzuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Po ashtu nga një pjesë e stafit, ankesë ishte dorëzuar edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës – tutje DHPGJSK. Dhoma e Posaçme, me datë 1 shkurt 2022 ka nxjerr aktgjykimin e tij me numër C-IV-21-0231 me ç ‘rast ka refuzuar ankesën e nëpunësve të Agjencisë rrjedhimisht ka lënë në fuqi vendimin e Bordit të Drejtorëve për zbritjen e pagave. Ndaj këtij vendimi

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

nëpunësit kanë parashtruar ankesë pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme me datë 15 shkurt 2022. Duke pas parasysh situatën se çështja e pagave ishte duke u trajtuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, KPMSHCK me datë 7 shkurt 2022 ka nxjerr vendim me të cilin e ka pezulluar çështjen e trajtimit të 150 ankesave të nëpunësve të Agjencisë derisa Dhoma e Posaçme të trajtojë këtë çështje përfundimisht.

Në pajtim me këtë në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 130 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në mbledhjen e datës 30 mars 2022 Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerr pikë veprimi me anë të cilit e ka pezulluar zbatimin e rregullores se pagave me zbritje derisa çështja të trajtohet përfundimisht nga organet vendimmarrëse përkitazi me ankesën e nëpunësve të Agjencisë.

Në kronologji të kësaj, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës si instancë përfundimtare, me datë 10 gusht 2022 ka nxjerr aktvendimin me numër AC-1-22-0067-A0001 me ç' rast hedhet poshtë si e papranueshme dhe shpallë veten jo kompetent për trajtimin e kësaj lënde në këtë gjykatë. Si rrjedhojë e kësaj, AKP me datë 11 gusht 2022 ka njoftuar KPMSHCK që çështja e ankesave të nëpunësve të Agjencisë pranë Dhomës së Posaçme është trajtuar përfundimisht nga kjo gjykatë ku e njëjta ka shpallur veten jo kompetente, dhe se ishin plotësuar të gjitha kushtet ligjore që KPMSHC të vazhdoj t'i trajtojë ankesat e nëpunësve të Agjencisë.

Me datë 07 tetor 2022 KPMSHC përmes një e-mail ka kërkuar nga AKP që t'i njoftoj të njëjtat se a ka ndonjë ankese tjetër e cila është duke u shqyrtuar nga ndonjë institucion tjetër në Republikën e Kosovës. Më datë 10 tetor 2022 AKP ka njoftuar KPMSHCK që në bazë të njohurive që ka, nuk ka ndonjë ankese tjetër e cila është në trajtim e sipër pranë ndonjë organi tjetër në Republikën e Kosovës.

Më datë 18 tetor 2022, AKP ka pranuar një e-mail nga KPMSHCK në të cilin konstatohet se do të bëjë aktivizimin e lëndëve dhe brenda afateve ligjore do të shqyrtoj të njëjtat dhe palët në procedurë do të njoftohen sipas rregullativës ligjore.

Në fund të muajit dhjetor 2022 AKP ka pranuar nga KPMSHCK një numër vendimesh lidhur me ankesat ndaj vendimit për zbritje të pagave nga Bordi i Drejtorëve, respektivisht me anë të këtyre vendimeve të Këshillit refuzohen ankesa e punonjësve dhe mbetet në fuqi vendimi i Bordit BD-153-9 i datës 29.10.2021 për aprovim të Rregullores se re për pagat në AKP.

Andaj, si rrjedhojë e tërë kësaj, ndryshimi/ri-kategorizimi i pagave për pozitat e stafit të AKP-së është bërë duke filluar me pagat e muajit janar 2023. Duke marr parasysh që vendimi fillestar i Gjykatës Themelore ka qenë në favor të nëpunësve publik stafit të AKP-së. Andaj, KPMSHCK ka bërë ankesë në Gjykatën e Apelit dhe nga muaji shkurt 2024 jemi në pritje të vendimit përfundimtarë nga Gjykata e Apelit. AKP edhe në kërkesat buxhetor për vitin fiskal 2024 dhe 2025 ka kërkuar buxhet shtesë dhe ka shpalosur të detyrimet kontingjente.

Lënda është ne rishqyrtim pranë KPMSHCK, në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A. Nr. 70/2023 datë 08/04/2024, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit A Nr. 557/2024 datë 11/12/2025.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 19 RAPORT PËR PASURINË JO FINANCIARE

19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)

	2025	2024	2023
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Softuerët	5,143	6,000	-
Pajisjet - Hardver	19,342	16,031	36,214
Pajisjet tjera	36,026	44,007	11,00
Pasuri i paprekshme	19,384	22,522	15,662
Gjithsej	79,895	88,560	62,876

* janë paraqitur vlerat neto pas zhvlerësimit të realizuar deri më 31 dhjetor 2025

PËRSHKRIMI		Vlera
Gjendja fillestare e vlerës neto të kapitaleve		88,560
*Blerjet gjatë vitit 2025	+	16,583
Zhvlerësimi gjatë vitit 2025	-	(25,248)
Vlera neto e kapitaleve më 31 dhjetor 2025	=	79,895

Më datën 20 tetor 2025 u.d. Drejtori Ekzekutiv ka lëshuar vendimin DE 1146-2025për formimin e Komisioneve regjistrim të rregullt të pasurive të AKP-së për vitin 2025 nga të cilat janë gjeneruar raportet finale mbi pasuritë.

Zhvlerësimi i pasurive:

AKP raporton koston historike, zhvlerësimin dhe vlerën neto të pasurive deri më 31 dhjetor 2025. Të dhënat janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 4.

Agjencia Kosovare e Privatizimit gjegjësisht Departamenti i Financave dhe Buxhetit menaxhimin e aseteve të AKP-së e bënë duke u bazuar në bazën e të dhënave të mirëmbajtur nga vet departamenti, në pa mundësi që të qaset dhe të bazohet në sistemin “E-Pasuria”, nëpërmjet të cilës të gjitha institucionet do të regjistrojnë, monitorojnë dhe kontrollojnë asetet e tyre por e cila ka vite që nuk funksionon. Gjatë muajit shtator 2023 kemi filluar bartjen manuale të të dhënave në sistem por kemi hasur në vështirësi të mëdha gjatë këtij procesi por jemi këmbëngulës që këtë proces ta përfundojmë aq sa është e mundur për shkak të mundësive teknike që na ofrohen.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Lista detaje e pasurive kapitale është vendosur në FTP server dhe është dërguar ne MFPT me USB, me dorëzimin e Pasqyrave Financiare.

19.3.2 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO)

AKP-ja bënë llogaritjen e zhvlerësimit sipas (Rregullorja 2/2013 e datës 18 Nëntor 2013 e MF-së për menaxhimin e pasurive) ato janë të paraqitura si më poshtë:

	2025	2024	2023
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Pajisjet dhe mobilet	82,261	94,392	101,959
Gjithsej	82,861	94,392	101,959

PËRSHKRIMI	Vlera	
Gjendja fillestare e vlerës neto të inventarit		94,392
*Blerjet gjatë vitit 2025	+	25,470
Zhvlerësimi gjatë vitit 2025	-	(37,001)
Vlera neto e inventarit më 31 dhjetor 2025	=	82,861

Të dhënat detaje janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 3. Lista detaje e inventarit është vendosur në FTP server dhe është dërguar ne MFPT me US, me dorëzimin e Pasqyrave Financiare.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

19.3.3 STOQET

	2025	2024	2023
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Stoqet	21,285	13,857	20,420
Gjithsej	21,285	13,857	20,420

	Viti2025				
PËRSHKRIMI	2024	*Korrigjim 2024	Hyrje	Dalje	Bilanci
Material administrativ	7,011	7,697	4,000	(8,073)	10,635
Material higjienik	6,846	(4,738)	10,760	(8,519)	4,350
Furnizim me ujë	-	334	2,633	(2,643)	324
Frigoriferi dhe kablllo vazhduese	-	-	1,832	(9)	1,824
Karrige/dollapa/varëse	-	-	4,665	(513)	4,152
Vlera e stoqeve më 31 dhjetor 2025	13,857	3,293	23,890	(19,757)	21,285

***Korrigjimet kontabël për vitin 2024:** Si rezultat i problemeve të vazhdueshme me funksionimin e sistemit E-Pasuria dhe përdorimit të proceseve alternative/manuale për regjistrimin e hyrje-daljeve, janë krijuar ndër vite mos-përputhje ndërmjet gjendjes reale të stokut në depo dhe raporteve të mëparshme; pas numërimit manual, analizës së të dhënave dhe krahasimit me regjistrat ekzistues, është evidentuar një diferencë pozitive prej **EUR 3,293**. Mos-përputhjet lidhen kryesisht me mosgjenerimin e raporteve të besueshme nga sistemi, mungesën e harmonizimit të artikujve, gabime gjatë futjes së të dhënave, sfida operative gjatë bartjes në ambientet e reja si dhe ndryshime në staf/paqëndrueshmëri në adaptimin teknologjik. Që nga gushti 2024 është angazhuar një zyrtar i ri i depos, i cili ka përmirësuar dukshëm kontrollin, dokumentimin dhe monitorimin e stokut përmes procedurave të rregullta dhe kontrollit të dyfishtë, duke mundur identifikimin dhe arsyetimin e diferencave; në fund të vitit 2025 është kërkuar edhe komision i posaçëm për verifikimin e vlerave sipas faturave origjinale dhe harmonizimin përfundimtar me të dhënat historike, ndërsa pas inventarit rezulton se gjendja e materialeve administrative dhe higjienike në depo është në përputhje me gjendjen e raportuar më 31 dhjetor 2025.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Konkluzion

Pas përfundimit të inventarit dhe analizës krahasuese, rezulton që **gjendja për materialet administrative dhe higjienike në depo është në përputhje me gjendjen e raportuar më 31 dhjetor 2025.**

Neni 20 RAPORT PËR AVANCE E PAARSYETUARA

Agjencia nuk ka avanse të paarsyetuara.

Data e Lëshimit	Nr. i CPO	Qëllimi	2025
			€
			0.00
			0.00
			0.00
			0.00
Gjithsej			0.00

Neni 21 RAPORT PËR TË HYRAT VETANAKE TË PASHPENZUARA

Sa i përket realizimit të hyrave dhe financimit të aktiviteteve të AKP-së, ato janë të hyrat e dedikuara dhe janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 23.

Përshkrimi	2025	2024	2023
	€	€	€
Të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat vetanake të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 22 RAPORT PËR BILANCET E PASHPENZUARA TË FONDIT ZHVILLIMOR NË MIRËBESIM

Agjencia nuk ka bilance të pashpenzuara dhe/apo që mund të përdor Fondin Zhvillimor në Mirëbesim.

	2025	2024	2023
Përshkrimi	€	€	€
Të hyrat nga Fondit Zhvillimor në Mirëbesim të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat nga Fondit Zhvillimor në Mirëbesim të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

Neni 23 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA

Raporti i të hyrave të dedikuara për vitin 2025 është si më poshtë:

	2025	2024	2023
Përshkrimi	€	€	€
Të hyrat e dedikuara të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat e dedikuara të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e pa alokuar nga Thesari	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 24 RAPORT PËR FONDET E DONATORËVE TË PASHPENZUARA

Agjencia nuk ka pranuar fonde nga donatorët dhe nuk ka fonde të donatorëve të pashpenzuara:

	2025	2024	2023
Përshkrimi	€	€	€
Të hyrat nga donatorët të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat nga donatorët të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

Neni 25 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE

Agjencia Kosovare e Privatizimit, në tabelën e mësipërme ka paraqitur numrin e punëtorëve sipas programit buxhetor në Ministrinë e Financave. Për sqarim, ky numër i punëtorëve nuk është vetëm në këtë Departament, por në Departamentet, Njësitë dhe 5 Zyrat Rajonale të AKP-së.

Departamenti	Nr. i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2025		Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2024		Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2023	
	I aprovuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Administratës	234	201	-	209	-	214	-
Gjithsej	234	201	-	209	-	214	-

Rrjedha e ndryshimeve gjatë vitit 2025 si dhe pasqyrimi i ngjarjeve të vitit 2024 të stafit të AKP-së është sipas tabelës të mëposhtme:

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PËRSHKRIMI	MESHKUJ	FEMRA	GJITHSEJ	Renditja
Numri i punëtorëve në fillim të vitit	111	98	209	1
Punëtor të ri	1	1	2	2
Dorëheqje	2	1	3	3
Pension	5	2	7	4
Gjithsej	105	96	201	5=1+2-3-4
<i>Brenda listës të pagave janë:</i>	<i>MESHKUJ</i>	<i>FEMRA</i>	<i>GJITHSEJ</i>	
<i>Pension të parakohshëm</i>	3	0	3	
<i>Pushim pa pagesë</i>	2	2	4	
<i>Lista e Pritjes</i>	3	0	3	

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 26 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE JASHTË LISTËS SË PAGAVE

Për vitin raportues dhe dy vitet paraprake, Agjencia nuk ka paguar punëtor të angazhuar jashtë listave të pagave. Pagesat për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të AKP-së, Tatimet dhe Kontributet e këtyre procedohen nga kodi ekonomik “Funksionarët me kohë të pjesshme” (11441). Kompensimi për 8 Anëtarëve të Bordit të AKP-së janë pagesa fikse mujore për shërbimet dhe angazhimin e tyre në përputhje me rregulloren për kompensimin e Bordit të Drejtorëve. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 6 gusht 2021 emëroi Bordin e Drejtorëve të AKP-së prej tetë (8) anëtarë.

Më 2 gusht 2024 një anëtar i bordit të drejtorëve ka dhënë dorëheqje dhe deri më 6 gusht 2025 Bordi funksionoi me 7 (shtatë) anëtarë. Pas 6 gushtit 2025, pesë (5) anëtarëve të emëruar më 6 gusht 2021 u përfundoi mandati dhe, sipas Ligjit nr. 06/L-023, Bordi nuk kishte më kuorum për mbajtjen e mbledhjeve.

Më 13 gusht 2025 Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dha dorëheqje dhe aktualisht me mandat aktiv ka mbetur vetëm një (1) anëtar.

Departamenti	Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2025		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2024		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2023	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Administratës	-	1	-	8	-	8
Departamenti i Shitjes	-	-	-	-	-	-
Departamenti Ligjor	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	1	-	8	-	8

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 27 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE ME KONTRATE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

Departamenti	Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2025		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2024		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2023	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti 1	-	-	-	-	-	-
Departamenti 2	-	-	-	-	-	-
Departamenti 3	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-	-

Neni 28 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Raporti është për vitin 2025 për raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të vitit 2024 për Buxhetin e AKP-së

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Zyrtari-ët Përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Pagat dhe mëditjet	Emërimi i komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit nga Bordi i drejtorëve në	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se vlerësimi i menaxhmentit është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nuk i delegohet asnjë personi /komisioni tjetër. Për më tepër, të siguroj që për detyrat që janë pjesë e përgjegjësisë të rregullta të mos bëjë asnjë kompensim shtesë.	Edhe pse është vlerësuar që pagesa e komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit ishte e justifikuar, kemi deklaruar se nëse auditorët e konsiderojnë si të parregullt, ne do ta ndërpresim. Si rrjedhojë konfirmojmë se praktika e	Sekretariati i Bordit	1 korrik 2025

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Zyrtari-ët Përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
		kundërshtim me kërkesat ligjore		pagese së komisionit do të ndërpritet plotësisht nga muaji korrik 2025. Vlersimi i punës së menaxhmentit do të realizohet vetëm në përputhje të plotë me kërkesat ligjore.		
2	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Mos funksionimi i sistemit "e-pasuria"	Bordi i Drejtorëve duhet të marrë veprime të nevojshme dhe të vazhdueshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria	Ne e ritheksojmë se funksionalizimi i sistemit e-pasuria është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Megjithatë ne do të vazhdojmë që me ngulm të kërkojmë nga ata që të vë në funksion sistemin në mënyrë që të na mundësohet përdorimi i tij i rregullt dhe në përputhje me kërkesat ligjore.	Departamenti i Administratës	1 korrik – 31 dhjetor 2025